



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT BESNIK DOKUSHI

SEKRETARIA
Datë 30.07.2019
Nr. 738 Regj. Nr. 2415 Prot.

URDHËR

"për vënien e sekuestros konservative"

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Për dijëni: S&M Oil 2018 sh.p.k me NIPT L81610025F
Për dijëni: Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial

TIRANË
QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 10492 Prot.
Datë 1.8.2019

Pranë Zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Besnik DOKUSHI me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përbarimore me palë:

Debitori: S&M Oil 2018 sh.p.k me NIPT L81610025F
Kreditorit: Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
Objekti: Pagim Gjobe

Unë Përmbaruesi Gjyqësor privat Besnik DOKUSHI pasi shqyrtova materialin e dosjes përbarimore:

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv Vendim Gjobe Nr.10568 Prot , datë 13.12.2018 për subjektin S&M Oil 2018 sh.p.k me NIPT L81610025F dhe me palë kreditore Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Nr.816 Regj.Them, datë 06.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt:

"Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për titullin ekzekutiv Vendim Gjobe Nr.10568 Prot , datë 13.12.2018 për subjektin S&M Oil 2018 sh.p.k me NIPT L81610025F"

Në datën 26.07.2019 në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e bllokimit në kuotat e palës debitore S&M Oil 2018 sh.p.k me NIPT L81610025F.

Per kete arsye:

Si dhe në bazë të neneve 519 të K.Pr.Civile,

URDHEROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë verifikimin dhe bllokimin e kuotave të debitorit S&M Oil 2018 sh.p.k me NIPT L81610025F si dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe ose disponimin e tyre dhe moskryerjen e asnjë lloj veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar .
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dh në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet ne 5 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR
BESNIK DOKUSHI